



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:141276

Datë: 22.04.2021

Numri i dokumentit: 01720498

P.nr.1010/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtarja e vetme gjykuese Fitore Daci si dhe me bashkëpunëtorin profesional Shkelzen Polloviqi, në çështjen penale ndaj të pandehurit G.M, nga Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Ngasja në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par 3 të KPRK-së dhe veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr.1359/20,të datës 25.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e përfaqësuesit të akuzës, Prokurores së shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, të pandehurit G.M, me datë 01.04.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

G.M i lindur me datë..., në komuna Ferizaj, me vendqëndrim në shtetin e Gjermanisë, nga i ati A. dhe e ëma S. e vajzërisë A. , i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, me profesion moler, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

I

Me datë 26.07.2020, rreth orës 15:33 në magjistralen Ferizaj- Prishtinë, në Auto-sallonin "A....", i pandehuri duke e drejtuar automjetin nën ndikim të alkoolit, duke vrapuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit numër 05/L-088 nenin 411 par 1, nenin 53 par 1 dhe nenin 68, deri sa ishte duke drejtuar veturën e tij model..., me targa..., duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes dhe kushteve të rrugës, vendbanimin, udhëkryqin, ku kishte kolonë të automjeteve në dy kahje, duke u kyçur në drejtim të magjistrale Prishtinë – Ura e Gjilani, hynë në mes të dy kolonave me një shpejtësi të madhe duke mos u ndalur në shenjë "Stop", kalon rrugën magjistrale ku kishte shumë automjete në lëvizje dhe si pasojë e humbë kontrollin mbi automjetin dhe depërton në Auto-sallonin "A....", ku së pari e godet një automjet të tipit "...", pastaj një automjet të tipit "..." dhe ndalet tek automjeti i tipit "..." me ç 'rast një pjesë e automjeteve të goditura bien në kapakun e motorit të automjetit të tipit "...", kurse disa pjesë të automjeteve të dëmtuara bien në anësoren e majtë të automjetit të tipit "...", duke i shkaktuar të dëmtuarit G.S, dëm material në vlerën prej rreth 30.000 euro.

me këtë veprim ka kryer veprën penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par 3të KPRK-së.

II

Sepse:

Me datë 26.07.2020, në qendrën Emergjente në Ferizaj, pasi që kishte shkaktuar aksident trafiku në mënyrën e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të kësaj aktakuze, në momentin kur zyrtarët policor N.N, N.I dhe P.S kanë shkuar në qëndren Emergjente në Ferizaj për t'ia bërë alkooltestin , i pandehuri refuzon që ta bëjë alkooltestin dhe me atë rast fillon ti fyej dhe kanosë zyrtarët policor, të cilët pas kësaj e dergojnë të pandehurin në mbajtje prej 48 orëve.

Me këtë veprim ka kryer veprën penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par 5, lidhur me par 1 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 2,4,7,17,38,39, 40, 44, 69, 70, 71, 72 dhe 76 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Për veprën penale si në dispozitivin e I:

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muaj/katër/, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në dispozitivin e II:

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj/tre/, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Gjykata konform dispozitës se nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit G.M i shqipton :

DËNIM UNIK

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muaj/gjashtë/, i cili dënim konform nenit 44 të KPRK-së, dhe me pëlqimin e të pandehurit i shëndrrohet në dënim me gjobë në shumën prej 2.000 €/ dy mijë euro/, të cilin dënim obligohet të e paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë.

Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë brenda afatit prej 30 ditësh pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë, atëherë gjykata dënimin me gjobë do t`ia zëvendësojë me dënim burgimi, ashtu që për çdo 20 euro të pa paguar, do të e vuaj një ditë burgimi.

Të dëmtuarit G.S me vendbanim në Komuna e Vitisë, N.N, N.I dhe P.S, punëtor të Qendrës Emergjente në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civilo-juridik.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ (njëzetë euro), si dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 30.66 € (tridhjetë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit.

Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën e saj PP/II nr.1359/20 të datës 25.11.2020 ka ngarkuar të pandehurin G.M, nga Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 371 par 3 të KPRK-së si dhe veprës penale Pengim i personit zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar me datë 01.04.2021, në të cilën shqyrtim të pranishëm ishin përfaqësuesi i akuzës-prokurorja e shtetit Mimoza Sylahyseni dhe i pandehuri G.M.

Në fillim të këtij shqyrtimi në mbështetje të nenit 245 par. 2 të KPPK-së, gjyqtarja konstatoi se i pandehuri në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjen e aktakuzës nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara në nenin 245 par.4 të KPPK-se.

Pasi që gjykata e ka udhëzuar të pandehurin në kuptim të nenit 246 par. 1 të KPPK-së dhe pasi që i pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 246 par. 3 të KPPK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorës së shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i pandehuri e ka kuptuar në tërësi aktakuzën, duke vepruar sipas nenit 246 par. 4 të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I pandehuri G.M në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza, shtojë se jam i penduar për këto veprime që kam bërë, më vjen keq që e kam kryer këto vepra penale, të njëjtat i kam kryer pa dashje, në ditën kritike alkooli e ka bërë të vetën pra nuk kam qenë në dijeni për veprimet që i kam bërë, është hera e parë që kam rënë ndesh me ligjin, kërkojë nga gjykata mundësisht të më shqiptojë ndonjë dënim sa më të butë dhe gjatë matjes së dënimit Gjykata të e merr parasysh faktin se edhe pse palës së dëmtuar kompania ime e sigurimit ia ka paguar dëmin por unë me vetë dëshirë ia kam paguar edhe një shumë të konsiderueshme parash, i kam kërkuar falje për dëmin që ia kam shkaktuar dhe

gjithashtu Gjykata të ketë parasysh faktin se unë jetojë në shtetin e Gjermanisë dhe mundësisht të mos me shkaktohet ndonjë dëm sa i përket statusit tim në shtetin e Gjermanisë.

Prokurorja e shtetit Mimoza Sylaj-Hyseni me rastin e paraqitjes së mendimit të sajë, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të pandehurin, pasi pranimi fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe në përputhje me dispozitat ligjore të nenit 248 si dhe provat materiale të shkresave të lëndës.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPR-së, dhe me këtë rast vlerësoi se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova e të rastit konkret si: ekspertiza e aksidentit të trafikut e përpiluar me datë 09.11.2020 nga eksperti i komunikacionit F.S, deklarata e dëshmitarit K.S në polici e dhënë me datë 26.07.2020, procesverbali i marrjes në pyetje të pandehurit G.M në polici me datë 27.07.2020, procesverbali i datës 13.11.2020 i marrjes në pyetje të dëmtuarit G.S, skica e aksidentit, raporti i policit hetues i datës 26.07.202, raporti numër 2823 i Qendrës Emergjente në Ferizaj të datës 26.07.2020 për G.M dhe foto dokumentacioni i lëndës dhe gjykata vlerësoi se aktakuza nuk ka gabime faktike apo ndonjë shkelje të qartë ligjore dhe po ashtu ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale Ngasja në gjendje të paafte apo të dehur nga neni 371 par 3 të KPRK-së dhe veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së, ashtu siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, Gjykata vlerësoi rrethanat në kuptim të nenit 71 dhe 72 të KPRK-së, dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se i pandehuri në shqyrtimin fillestarë e ka pranuar fajësinë, ndërsa si rrethana lehtësuese mori pendimin e sinqertë dhe real për veprat penale të kryera, ka qenë i kujdesshëm pas aksidentit me pronarin e auto sallonit-të dëmtuarin, i martuar, baba i tre fëmijëve, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale.

Gjykata është e bindur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Të dëmtuarit G.S me vendbanim në Komuna e Vitisë, N.N, N.I dhe P.S, punëtor të Qendrës Emergjente në Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civilo-juridik.

Konform nenit 453 par.1 të KPRK-së, obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20€ (njëzetë euro), si dhe në emër të ekspertizës së komunikacionit shumën prej 30.66 € (tridhjetë euro e gjashtëdhjetë e gjashtë cent), të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, pasi që aktgjykimi të e merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit.

Obligohet i pandehuri që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 € (tridhjetë euro), brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit.

Në bazë të asaj që theksuam më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL
P.nr. 1010/20, datë 01.04.2021

Bashkëpunëtori profesional
Shkelzen Polloviqi

Gjyqtarja
Fitore Daci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.